



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.3741/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Gëzim Lllulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike të paditëses T. I., nga Ferizaj, rr.”.....” nr.5, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati H.SH. nga Prishtina, kundër të paditurit B.K. nga Ferizaj, Rr.”.....” Lam... nr.9, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate A.SH. nga Ferizaj, për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditëses, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.189/16 të dt.17.07.2020, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 30.07.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditëses T.I. nga Ferizaj, rr.”.....” nr...., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.189/16 i dt.17.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses T.I. nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar: të vërtetohet se i padituri B.K. nga Ferizaji ka bërë fyerje të rënda ndaj paditëses me fjalët ofenduese me të rënda që ekzistojnë dhe si pasojë me këto veprime ka shkaktuar dëme jo materiale, të obligohet i padituri që të ia paguaj paditëses në emër të kompensimit shumën për dëmin e shkaktuar duke ofenduar paditësen me fjalët më të rënda që ekzistojnë, shumën prej 10000 euro, për shkak deklaratës dhe sjelljes fyese e drejtuar paditëses, për shkaktimin e frikës shumë të madhe, në raporte familjare, nga thëniet e të paditurit ka mund të shkatërrohet e gjithë familja, shumën prej 5000 euro, gjithsejtë shumën prej 15000 mijë euro, e të gjitha me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë gjerë në pagesën përfundimtare. Në pikën II të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesa paditëses T.I. me të cilën i ka kërkuar shpenzimet e procedurës. Në pikën III të dispozitivit, detyrohet paditësja T.I. nga Ferizaj, që të paditurit B.K. nga Ferizaj në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shuma siç vijon: për 4 seanca të mbajtura 1081.60 euro, për një seancë të shtyer 135.20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me të njëjtin aktgjykim në pikën IV të dispozitivit, refuzohet si e pabazuar kërkesa e të autorizuarës së të paditurit, me të cilën i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore për përgjigje në padi.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i paditëses brenda afatit ligjor kanë paraqit ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta miratoj ankesën si të bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar, ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë, brenda afatit ligjor ka paraqitur e autorizuar e të paditurit, me propozim që të refuzohet ankesa e paditëses si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, atë të përgjigjes në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja ka parashtruar padi kundër të paditurit, për kompensim dëmi. Paditësja ka theksuar se, është në marrëdhënie pune në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) Ferizaj, e punësuar si Infermiere që nga viti 1999 dhe njëherit është kryetare e Sindikatës së Punëtorëve Shëndetësor të QKMF-së, si dhe kryetare e Sindikatave të Shëndetësisë për Regjionin e Ferizajt. Me dt.04.12.2015, rreth orës 14:30 minuta, pas një prononcimi të paditëses për media (Koha Ditore), merr një telefonatë nga numri, nga tani i padituri, i cili në kohën e ngritjes së kësaj padie është drejtor i DSSHM-së në Ferizaj, ditë e premtë, ku paditësja është fyer rëndë nga i padituri, si dhe është kërcënuar me largim nga zyra. Për fjalët fyese që i padituri ka përdorur gjatë bisedës telefonike në seancë janë paraqitur edhe dëshmitarë-F.H. nga fshati Neredime, e cila ka dëgjuar pothuajse tërë bisedën. Më tej ka theksuar se, me dt.07.12.2015, dy ditë pas ofendimit nga ana e të paditurit, ka bërë publikimin në media lokale dhe kombëtare, për shkak se jam frikësuar nga pasojat e mëtejme personale. Artikulli lidhur me denoncimin e paditëses e ka botuar Koha Ditore me dt.09.12.2015, për fyerjet që i janë bërë nga i padituri. Gjithashtu i padituri ka dal me një deklaratë dhënë mediave, duke theksuar se nuk qëndrojnë të dhënat e paditëses, por vetëm e ka telefonuar. Paditësja ka theksuar se, ndihet e ofenduar nga fyerjet e të paditurit dhe njëkohësisht e kërcënuar, për shkak se është e martuar dhe ka 3 fëmijë të moshës madhore, familje të gjerë, duke i shkaktuar dëme të mëdha dhe se i njëjti duhet ta kompensoj në shumat e cekura si në padi, e në të cilën padi dhe kërkesëpadi ka mbetur edhe i autorizuari i paditëses në seancë gjyqësore. Kanë propozuar që të aprovet padia dhe kërkesëpadia e paditëses si e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar provat dhe i ka vlerësuar ato dhe në fund ka marrë aktgjykimin me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, me detaje të tjera të përshkruara më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, të gjykatës së shkallës së parë theksohet se, pas analizimit të deklaratës së dëshmitares F.H., nuk është vërtetuar fakti se i padituri, e ka fyer-ofenduar paditësen dhe e njëjta deklaratë është publikuar nga i padituri. Kjo bazuar në faktin se dëshmitarja për bisedën telefonike ka deklaruar se “nuk kam dëgjuar se çka ka thënë në telefon”. Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e paditëses, në cilësi të dëshmitares, mirëpo të njëjtës nuk ia fali besimin sepse, me asnjë provë nuk ka arritur që ta vërtetoj faktin se i padituri ka ofenduar të njëjtën dhe se ajo deklaratë është publikuar.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe provën një faqe nga gazeta Koha Ditore, mirëpo sipas gjykatës kjo provë nuk ka vërtetuar faktin se, i padituri ka fyer-ofenduar paditësen, ngase faqja e gazetës në fjalë, është bazuar vetëm në thëniet e paditëses. Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe dokumentet mjekësor si në shkresat e lëndës, mirëpo të njëjtat nuk kanë vërtetuar faktin se i padituri ka ofenduar-fyer paditësen. Pastaj nga njoftimi i dt.23.12.2019, i lëshuar nga Posta e Kosovës, lista shoqëruese e dërgesave të regjistruara e dt.07.03.2016, është vërtetuar se nuk ka dëshmi që paditësja ka dorëzuar padinë në gjykatë, kurse dëshmia është se kjo dërgesë është punuar dhe vendosur në gjykatë me dt.7.03.2016, pra, në rastin konkret, paditësja nuk e ka vërtetuar se, padinë e ka parashtruar brenda afatit ligjor sepse, nga dt.04.12.2015 deri me dt.07.03.2016, bëjnë më shumë se tre muaj. Krejt në fund ka vendosur edhe lidhur me shpenzimet e procedurës, duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Këtë gjendje faktike të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, nenit 3 par.1 pika b), 17 par.1 të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, si dhe nenit 452.1 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e po ashtu edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditëses, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës për pa i theksuar dispozitat të cilave iu referohet, siç pretendon në ankesë sepse, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë, e në të cilin arsyetim, janë dhënë arsye konkrete për faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë, e të cilat fakte janë elaboruar qartë edhe në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, ashtu që nuk mund të thuhet se aktgjykimi është i kundërligjshëm, siç pretendon pa të drejtë ankesa e paraqitur.

Pra, aktgjykimi i atakuar, nuk përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i tij është i kuptueshëm dhe nuk është kontradiktor me vetvete apo me arsyet e tij, ndërsa arsyet e dhëna janë të qarta, nuk janë kontradiktore nuk janë në kontradiktë me përmbajtjen e dokumenteve dhe procesverbaleve të cilat gjenden në shkresa e kësaj lënde. Edhe sa i përket pretendimit se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë provën e publikimit në Koha Ditore, Gjykata e Apelit e vlerësoj një provë të tillë, por duke u bazuar në faktin se një publikim i tillë nuk e ka vërtetuar faktin se, i padituri e ka fyer-ofenduar paditësen, siç kërkohet me dispozitat përkatëse ligjore të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, atëherë edhe përkundër asaj se nga gjykata e shkallës së parë kjo është përmendur specifikisht në aktgjykimin e atakuar, kjo tani edhe nga Gjykata e Apelit rezulton të jetë pa ndonjë ndikim në epilogun përfundimtar të aktgjykimit të atakuar dhe në aktgjykimin që tani e mori kjo gjykatë, nga arsyet e sipër cekura, e sidomos për faktin se nga pala paditëse nuk është argumentuar me ndonjë provë materiale konkrete se i padituri e ka ofenduar-fyer të njëjtën.

Gjithashtu, gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes i ka çmuar provat veç e veç dhe të gjitha provat së bashku. Prandaj, ashtu siç kërkohet me dispozitën ligjore të nenit 8 të LPK-së, edhe është vepruar nga gjykata e shkallës së parë, në procedurën e zhvilluar lidhur me çështjen kontestuese të paditëses dhe në fund gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin e sajë të ligjshëm dhe të drejtë.

Gjykata e Apelit, sa i përket pretendimit ankimor lidhur me faktin që duhet pasur parasysh edhe deklaratat, e vlerësoj edhe deklaratën e dëshmitares F.H., e propozuar si dëshmitare nga ana e paditëses në këtë procedurë në gjykatën shkallës së parë, mirëpo e njëjta me dëshminë e saj në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 24.12.2019, ka deklaruar se nuk e di kush ka qenë në telefon dhe me kë ka biseduar paditësja, por di se nuk ka qenë komunikim i mirë, me detaje si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, sipas të cilës deklaratë gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktin se i padituri ka fyer-ofenduar paditësen, e të njëjtin mendim e ndan edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar dhe konstatuar edhe gjendjen faktike, sepse me prova dhe dëshmi të cilat gjenden në shkresat e lëndës, paditësja nuk ka arritur me asnjë provë ta bind gjykatën të vendos ndryshe nga ajo siç është vendosur me aktgjykimin e atakuar. Andaj sipas Gjykatës së Apelit, bazuar në nenin 319 të LPK-së me të cilin parashihet se *”Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, atëherë, meqenëse paditësja në rastin konkret nuk ka arritur që të provoj një fakt të tillë, edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marrë një vendim të drejtë kur ka vendosur lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, kundër të paditurit si të pabazuar.

Pra, nga e gjithë kjo që u theksua më sipër rezulton se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditëses, për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ashtu që pretendimet e tilla u refuzuan të pa bazuara nga kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, edhe e drejta materiale në këtë çështje kontestuese të paditëses, është zbatuar drejtë nga se gjykata e shkallës së parë, e cila drejtë i është referuar dispozitave ligjore në aktgjykimin e atakuar, të cilat aplikohen në situata të tilla si kjo e paditëses, kështu që në këtë aspekt pretendimi ankimor nuk është i bazuar dhe si i tillë u refuzua nga kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë, në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar ka dhënë përshkrim të mjaftueshëm të dispozitave ligjore nga ligji i veçantë i cili është në zbatim, pra të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nr. 02/L-65, ku është sqaruar ndër të tjera edhe për masat për mbrojtjen nga shpifja dhe fyerja, të përcaktuara me Kapitullin I, në nenin 3 par.1 pika b), ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se *”fyerja nënkupton deklarinimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”*, e që në rastin konkret paditësja, nuk ka arritur që ta provoj një fakt të tillë, me ndonjë provë konkrete.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerësoj se, paditësja vërtetë ka parashtruar padinë pas afatit ligjor për paraqitjen e një kërkesë për kompensimin e dëmit në bazë të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, ku me nenin 17 të këtij ligji parashihet se *”Afati për paraqitjen e një kërkesë për kompensim në bazë të këtij Ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e një faktit të pavërtetë dhe identitetin e autorit..”*, pra siç është vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, paditësja ka theksuar se, rasti ka ndodhur me dt.04.12.2015, ndërsa padinë e ka parashtruar në gjykatë me dt.07.03.2016, pra pasi që kanë kaluar më shumë se 3 muaj.

Prandaj, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, si të drejtë dhe të ligjshëm, e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Për shkak se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike dhe në mënyrë të drejtë është zbatuar e drejta materiale, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, atëherë nga të gjitha arsyet e paraqitura, e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË

Ac.nr.3741/2020 i dt.30.07.2021

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Llulluni